

V E N D I M
Nr. 155, datë 1.4.1999

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE LAJMËRIMIT TË POPULLATËS NË RAST
KUSHTRIMI AJROR

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institucionet qendrore, prefekturat, bashkitë, këshillat e rretheve dhe komunat, të vendosin mjetet dhe sinjalet e kushtrimit ajror.

2. Me dhënien e urdhërit për kushtrimin ajror nga Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë të detyruar për ta transmetuar:

Radio-Televizioni shqiptar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Postave të Shqipërisë kur ai është për të gjithë territorin e vendit.

Media elektronike lokale kur ai është i pjesshëm.

3. Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Informacionit dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrin aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

4. Shpenzimet për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga fondet e miratuara për këto institucione, për vitin 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko